

RELACION

PËR PROJEKTVENDIMIN

“PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 162, DATË 19.2.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ‘PËR RREGULLAT E HOLLËSISHME PËR HARTIMIN, MIRATIMIN, RISHIKIMIN DHE ZBATIMIN E PROGRAMEVE TË PAKËSIMIT TË SHKARKIMEVE NË AJËR”

I. QËLLIMI I PROJEKTVENDIMIT

Qëllimi i projektvendimit është përditësimi dhe përmirësimi i disa dispozitave të aneksit III të vendimit nr. 162, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, me qëllim forcimin e kërkesave teknike për hartimin dhe përditësimin e projeksioneve të shkarkimeve në ajër dhe përmirësimin e përputhshmërisë së tyre me metodologjitë ndërkombëtare të raportimit. Ndryshimet synojnë të sigurojnë që procesi i hartimit dhe zbatimit të Programit Kombëtar për Pakësimin e Shkarkimeve në Ajër të jetë në përputhje me praktikat dhe standardet ndërkombëtare për raportimin e shkarkimeve të ndotësve në ajër.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KESHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TE AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektvendim është parashikuar në katërmujorin e dytë të Programit të Përgjithshëm Analitik të Projektakteve për vitin 2026 dhe është në përputhje me programin politik të Këshillit të Ministrave dhe me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE).

Hartimi i këtij vendimi është gjithashtu në përputhje me kërkesat që burojnë nga Pozicioni Negociues për Shqipërinë, ku në analizën e legjislacionit l është evidentuar nevoja për përmirësimi i bazës ligjore për fushën e ajrit.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Relacion për projektvendimin “Për disa shtesa në vendimin nr. 162, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, ‘Për rregullat e hollësishme për hartimin, miratimin, rishikimin dhe zbatimin e programeve të pakësimit të shkarkimeve në ajër’

Vendimi nr. 162, datë 19.2.2020, përcakton rregullat e hollësishme për hartimin, miratimin, rishikimin dhe zbatimin e programeve të pakësimit të shkarkimeve në ajër, në zbatim të ligjit nr. 162, datë 4.12.2014, “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, i ndryshuar.

Gjatë zbatimit të këtij vendimi, si dhe në kuadër të procesit të përmirësimit të kuadrit rregullator dhe harmonizimit të tij me standardet ndërkombëtare dhe praktikat e Bashkimit Evropian në fushën e cilësisë së ajrit, është evidentuar nevoja për disa përditësime teknike në Aneksin III, që lidhen kryesisht me:

- përditësimin periodik të projeksioneve të shkarkimeve në ajër;
- harmonizimin e metodologjisë së përgatitjes së projeksioneve me metodologjitë ndërkombëtare të raportimit;
- sigurimin e përputhshmërisë ndërmjet projeksioneve të shkarkimeve dhe inventarëve kombëtarë të shkarkimeve;
- përmirësimin e kërkesave për monitorimin dhe raportimin e disa ndotësve të ajrit.

Për këtë arsye është propozuar amendimi i disa dispozitave të Aneksit III të vendimit nr. 62/2020.

2. Problematikat që adreson projektakti

Projektakti adreson disa mangësi të kuadrit rregullator aktual, i cili nuk përcakton frekuencën e përditësimit të projeksioneve të shkarkimeve, nuk referon në mënyrë të qartë përdorimin e Nomenklaturës për Raportim (NFR) dhe metodologjive të Konventës për Ndotjen Ndërkufitare të Ajrit në Distançë të Largët (CLRTAP), si dhe nuk pasqyron zhvillimet më të fundit lidhur me raportimin e karbonit të zi dhe masat për reduktimin e shkarkimeve të amoniakut. Në mungesë të këtyre përditësimeve, ekziston rreziku që projeksionet kombëtare të shkarkimeve të mos jenë plotësisht të harmonizuara me inventarët kombëtarë të shkarkimeve dhe me kërkesat metodologjike të raportimit ndërkombëtar, duke ndikuar në cilësinë e planifikimit, monitorimit dhe raportimit të politikave për pakësimin e shkarkimeve në ajër.

3. Efektet e pritshme nga zbatimi i projektaktit

Relacion për projektvendimin “Për disa shtesa në vendimin nr. 162, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, ‘Për rregullat e hollësishme për hartimin, miratimin, rishikimin dhe zbatimin e programeve të pakësimit të shkarkimeve në ajër’

Projektakti adreson disa mangësi të kuadrit rregullator aktual, i cili nuk përcakton frekuencën e përditësimit të projeksioneve të shkarkimeve, nuk referon në mënyrë të qartë përdorimin e Nomenklaturës për Raportim (NFR) dhe metodologjive të Konventës për Ndotjen Ndërkufitare të Ajrit në Distançë të Largët (CLRTAP), si dhe nuk pasqyron zhvillimet më të fundit lidhur me raportimin e karbonit të zi dhe masat për reduktimin e shkarkimeve të amoniakut. Këto mangësi ndikojnë në një harmonizim jo të plotë të projeksioneve me inventarin kombëtar të shkarkimeve dhe me kërkesat metodologjike të raportimit ndërkombëtar.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektvendim synon përmirësimin dhe përditësimin e kuadrit rregullator në fushën e pakësimit të shkarkimeve të ndotësve në ajër, në përputhje me praktikën dhe metodologjitë ndërkombëtare të raportimit. Në këtë kuadër, ai kontribuon në përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit kombëtar me kërkesat e Direktivës (BE) 2016/2284 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 14 dhjetor 2016, për reduktimin e shkarkimeve kombëtare të ndotësve atmosferikë, që ndryshon Direktivën 2003/35/EC dhe shfuqizon Direktivën 2001/81/EC. Ndryshimet e propozuara mbështesin zbatimin e kërkesave të kësaj direktive në lidhje me përgatitjen, përditësimin dhe raportimin e projeksioneve të shkarkimeve në ajër, si dhe përmirësimin e përputhshmërisë së tyre me inventarët kombëtarë të shkarkimeve.

Gjithashtu, projektvendimi merr në konsideratë kërkesat metodologjike të raportimit në kuadër të Konventës për Ndotjen Ndërkufitare të Ajrit në Distançë të Largët (CLRTAP), në të cilën Republika e Shqipërisë është palë, si dhe praktikën dhe metodologjitë e përdorura në kuadër të raportimit ndërkombëtar të shkarkimeve të ndotësve në ajër.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRES (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Relacion për projektvendimin "Për disa shtesa në vendimin nr. 162, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, 'Për rregullat e hollësishme për hartimin, miratimin, rishikimin dhe zbatimin e programeve të pakësimit të shkarkimeve në ajër'

Projektvendimi përafron në mënyrë të pjeshme Directive (EU) 2016/2284 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për Reduktimin e Shkarkimeve Kombëtare të Ndotësve Atmosferik që ndryshon Direktivën 2003/35/EC dhe shfuqizon Direktivën 2001/81/EC.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi parashikon disa ndryshime dhe shtesa në Aneksin III të vendimit nr. 62, datë 19.2.2020, si më poshtë:

- Parashikimin e detyrimit që projeksionet e shkarkimeve të përditësohen të paktën çdo dy vjet, me qëllim sigurimin e një vlerësimi më të rregullt dhe të përditësuar të zhvillimeve në shkarkimet e ndotësve në ajër.
- Përcaktimin që projeksionet e shkarkimeve të përgatiten dhe analizohen në nivelin e kategorive të burimeve sipas Nomenklaturës për Raportim (NFR), për të garantuar përputhshmërinë me sistemin e raportimit të inventarëve kombëtarë të shkarkimeve në ajër.
- Shtimin e një reference të qartë për përdorimin e metodologjive dhe formateve të raportimit të Konventës për Ndotjen Ndërkufitare të Ajrit në Distançë të Largët (LRTAP) gjatë përgatitjes së projeksioneve të shkarkimeve.
- Përditësimin e dispozitave që lidhen me masat për reduktimin e shkarkimeve të amoniakut, duke parashikuar që këto masa të marrin në konsideratë dokumentet më të fundit udhëzuese të përgatitura nga UNECE dhe teknikat më të mira të disponueshme.
- Sqarimin se shkarkimet e karbonit të zi monitorohen dhe raportohen si pjesë e inventarit dhe projeksioneve të lëndës së ngurtë pezull PM2.5, me qëllim përmirësimin e konsistencës së raportimit të ndotësve të ajrit.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Relacion për projektvendimin "Për disa shtesa në vendimin nr. 162, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, 'Për rregullat e hollësishme për hartimin, miratimin, rishikimin dhe zbatimin e programeve të pakësimit të shkarkimeve në ajër'

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi janë: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit; Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe institucionet e tjera përgjegjëse për raportimin e të dhënave sektoriale për shkarkimet në ajër. AKM është institucioni përgjegjës për hartimin e inventarit dhe projeksioneve të shkarkimeve, pasi kjo lidhet drejtpërdrejt me ndryshimet.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Për hartimin e këtij projektvendimi ka kontribuar struktura përgjegjëse për cilësinë e ajrit në Ministrinë e Mjedisit, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, si dhe me Drejtorinë e Programimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator dhe drejtoritë e tjera teknike të ministrisë.

Projektvendimi do të dërgohet për mendim nëpërmjet sistemit e-aktet tek Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator, Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe AMVV.

Projektvendimi i është nënshtruar procesit të njoftimit dhe konsultimit publik, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në zbatim të ligjit nr. 146/2014, "Për njoftimin dhe konsultimin publik", ai u publikua në Regjistrin Elektronik për Njoftimin dhe Konsultimin Publik (RENJKP) në periudhën 11 shkurt – 11 mars 2026. Gjatë kësaj periudhe, projektvendimi regjistroi 289 shikime në portal, ndërsa nuk u paraqitën komente apo propozime nëpërmjet tij.

Paralelisht me konsultimin elektronik, Ministria e Mjedisit, në zbatim të legjislacionit sektorial për zhvillimin e dëgjësive publike për projektakte normative, plane dhe programe në fushën e mjedisit, zhvilloi një proces të zgjeruar konsultimi me institucionet publike, njësitë e vetëqeverisjes vendore, komunitetin e biznesit, organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët ndërkombëtarë, në kuadër të diskutimit të paketës ligjore për cilësinë e ajrit.

Relacion për projektvendimin "Për disa shtesa në vendimin nr. 162, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, 'Për rregullat e hollësishme për hartimin, miratimin, rishikimin dhe zbatimin e programeve të pakësimit të shkarkimeve në ajër'

Më 28 prill 2026 u zhvillua mbledhja e Tryezës së Diskutimit dhe Këshillimit, gjatë së cilës u diskutuan Strategjia dhe Plan i Veprimit për Cilësinë e Ajrit, projektamendimet në ligjin për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, si dhe aktet nënligjore përkatëse. Pjesë e kësaj pakete ishte edhe projektvendimi "Për disa ndryshime në vendimin nr. 162, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, 'Për rregullat e hollësishme për hartimin, miratimin, rishikimin dhe zbatimin e programeve të pakësimit të shkarkimeve në ajër'". Më tej, më 1 korrik 2026, Ministria organizoi një takim konsultativ të dedikuar projektligjit dhe dy projektvendimeve të Këshillit të Ministrave për transpozimin e Direktivës (BE) 2024/2881, ku morën pjesë edhe përfaqësues të zyrës së asistencës teknike ESDO.

Gjatë procesit të konsultimit, diskutimet u përqendruan kryesisht në promovimin e mobilitetit të gjelbër dhe reduktimin e emetimeve, forcimin e rolit të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe të bashkëpunimit ndërinstitutional, përfshirjen e hershme të organizatave të shoqërisë civile në hartimin e legjislacionit, përmirësimin e komunikimit me publikun dhe sektorin privat, si dhe qartësimin e përgjegjësiwe institucionale për monitorimin dhe zbatimin e legjislacionit në fushën e cilësisë së ajrit. Gjatë këtij procesi nuk u paraqitën komente apo sugjerime konkrete lidhur me përmbajtjen e këtij projektvendimi.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE


Zbatimi i projektvendimit nuk ka efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit.

MINISTËR

Sofjan JAUPAJ

**Sofjan
Jaupaj**

Digitally signed by
Sofjan Jaupaj
Date: 2026.07.17
11:12:06 +0200



Relacion për projektvendimin "Për disa shtesa në vendimin nr. 162, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, 'Për rregullat e hollësishme për hartimin, miratimin, rishikimin dhe zbatimin e programeve të pakësimit të shkarkimeve në ajër'